



Raporti

Vjetor

2019



Raporti Narrativ Vjetor 2019**1. Informacion i përgjithshëm**

Periudha:	Janar 2019 – Dhjetor 2019
Emri i organizatës:	Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare”
Adresa zyrtare:	L. 3 Rr. Egnatia Nr 109, Durrës
Kodi postar:	2001
E- maili:	info@udhetimiilire.org
Faqe web:	www.udhetimiilire.org
Personi i kontaktit:	Miranda Mansaku
E-mail:	mirandamansaku@udhetimiilire.org
Phone number:	++355695720494

1. Përmbledhje e aktivitete të realizuara

1.1 Projekte të implementuara dhe në proces

➤ Nga **05.09.2018 – 30.05.2020**, shoqata ofron: Mbështetje teknike për "Analizë lokale kontekstuale për sistemin e portit të Durrësit" për projektin Transport i Integruar dhe i Qëndrueshëm në Rrjetin Efikas - ISTEEN, në kuadër të Programit INTERREG Adriatik-Jon. Projekti po implementohet nga Qarku i Durrësit si partner në këtë projekt.

➤ Nga **15.08.2018 – 31.12.2019**, shoqata është Eksperti i jashtëm për përkrahjen e Këshillit të Qarkut të Durrësit në krijimin e hartës së rrezikut të bregdetit EUSAIR, duke ndihmuar në ngritjen e rrjetit I-Storm, për projektin "*Integrated Sea sTORM Management Strategies*" I-STORM, në kuadër të programit INTERREG VB Adriatiko-Jonian. Projekti po implementohet nga Qarku i Durrësit si partner në këtë projekt.

➤ Nga **Qershori i 2018** deri në **Qershorin e 2019**, shoqata është partnere në projektin Erasmus + "Të rinjtë dorë për dorë për të pastruar detet" së bashku me Drejtorinë e Rinisë dhe Sporteve në Bashkinë e Stambollit.

➤ Nga muaj **Maj** deri në muajin **Dhjetor 2019**, shoqata UiL-LdV ka qënë partnere në projektin Erasmus + "Green Up" (në fushën e mjedisit), me 5 organizata nga e gjithë bota, si: Polonia, Italia, Serbia, Gjeorgjia dhe Tunizia. Në kuadër të këtij projekti u relaizuan edhe disa materiale promovuese siç ishin: Workshop Scenarios, video nga projekti, etj. Ato ishin fryt i bashkëpunimit të 36 të rinjve pjesëmarrës të këtij projekti. Projekti u financua nga programi Erasmus + EU.

➤ Nga **01.06.2019 – 31.12.2019**, shoqata "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare" ka implementuar projektin "Youth Guide for Durres". Ky projekt është mbështetur nga Programi Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor dhe financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Në kuadër të këtij projekti u zhvilluan një sërë aktiviteteve si:

- *Trajnimi i 64 të rinjve si guida të qytetit të Durrësit. Ata u trajnuan nga trajnerë ekspertë të fushave përkatëse dhe në fund morën certifikatë pjesëmarrje.*
- *Study tour në sitet arkeologjike dhe atraksionet turistike të qarkut të Durrësit.*
- *Praktika/Intership i të rinjve në operatorët turistik të Durrësit, në këtë mënyrë të rinjtë panë nga afër përgatitjet që bëhen për sezonin turistik.*
- *Trajnimi i 20 të rinjve në fushën e TIC dhe multimedias.*
- *Takime ndërgjegjësuese me studentë dhe nxënës për promovimin e vlerave turistike të qytetit të Durrësit.*
- *Publikimi i guidës së qytetit të Durrësit, e cila përmban materialet e përgatitura nga të rinjtë e trajnuar gjatë projektit.*

➤ Nga muaj **Qershor** deri në muajin **Nëntor 2019**, shoqata ka qënë partnere në youth exchange “Pop Up Arts – Balkan”. Lead partner i këtij projekti ishte organizata “EsaienRoi” nga Greqia, ndërsa partnerët e tjerë ishin nga Bosnje-Hercegovina dhe Bullgaria. Qëllimi i këtij projekti ishte promovimi i vlerave turistike, kulturore dhe humane të vendeve të Ballkanit. Follow up e projektit ishin artikujt e botuar nga pjesëmarrësit për promovimin e vlerave kulturore, përmes artit.

➤ Nga muaji **Nëntor 2019** deri në muajin **Nëntor 2020**, shoqata do të jetë partnere në projektin Erasmus + “Trendsetters”, së bashku me organizatën KAS Youth Hub, nga Anglia. Qëllimi i këtij projekti është promovimi i kulturave të ndryshme dhe të mësuarti përmes artit. Në të do të jenë pjesëmarrës të rinjë të cilët do të ndjekin projektin qysh prej fillimit me sesionet informuese e deri tek përgatitja e follow up.

➤ Që nga **20.12.2019** – më **26.12.2020**, shoqata do të implementojë projektin “Composting on farm – for Mitigation of Climate Changes” i cili financohet nga Ambasda e Bullgarisë në Tiranë në kuadër të programit “Ndhima zyrtare për zhvillim”. Projekti do të përfshijë në mënyrë të drejtëpërdrejtë 5 ferma të Njësisë Administrative Sukth dhe 4 shkolla të mesme të qytetit. Gjatë kësaj periudhe janë planifikuar një sërë aktivitete duke përfshirë implementimin e protokollit të kompostimit në ferma, trajnimin e qeverisë së nxënësve të shkollave pjesëmarrëse për problemet dhe çështjet mjedisore dhe ngritjen e Eko Klubeve, informimin e të rinjëve dhe fermerëve për rëndësinë e kompostimit dhe përdorimit të biomases.

1.2 Aktivitete të tjera të realizuara në kuadër të nismave të ndryshme

Prill 2019

▪ Në kuadër të projektit “Largimi, mbërritja, kthimi: dje, sot, nesër” që u zbatua nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim në partneritet me Unisco, Shkolla Leonik Tomeo Durrës dhe Gjimnazin ISS Pietro Sette (Bari), u zhvillua me **2 Prill takimi përmbyllës** me pjesëmarrës nga gjimnazi ISS Pietro Sette (Bari), gjimnazi “Leonik Tomeo”, Durrës, Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare”, Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Kongresi Rinor Kombëtar, etj,

▪ **Më 23 Prill**, në kuadër të Ditës së Tokës Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare”, zhvilloi **takime ndërgjegjësuese** me nxënësit e shkollës së mesme “Gjergj Kastrioti”, Durrës. Në to u trajtuan tema si riciklimi, ndotja e tokës, ndikimi i faktorit njerëzor në ndotjen e tokës. Në këtë linjë u përforcua dhe u rikujtua edhe njëherë rëndësia e riciklmit që në shkollë përmes përdorimit të koshave të diferencuar që janë vendosur në kuadër të projektit “Youth Eco Act” .

Maj 2019

- Shoqata "Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare" në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar në kuadër të "Manuali mbi qytetarinë aktive - Forcimi i rolit të të rinjve në procesin e përafrimit të Shqipërisë në BE" dhe mbështetjen e Hanns-Seidel-Stiftung zhvilloi me datat **18-19 maj** në ambientet e Shkollës "Hasan Koci" dhe në Pallatin e Kulturës, në Durrës **trajnim** dy ditor ku trajtuan tema si: Bashkimi Europian dhe procesi i integritit të Shqipërisë në BE, kontributi i rinisë dhe roli i tyre në integrim, sa janë të rinjtë e Durrësit pjesëmarrës në jetën ekonomike, politike dhe sociale.

Qershor 2019

- Shoqata "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare" si koordinatore lokale e Kongresit Rinor Kombëtar dhe me mbështetjen financiare të Fondacionit Friedrich Ebert zhvilloi në qytetin e Durrësit me datë **10 qershor aktivitetin e dytë në kuadër të projektit: "Le të veprojmë së bashku në formësimin e politikave lokale dhe qendrore të rinisë përmes dialogut të strukturuar"**. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues nga Bashkia e Durrësit, Zyra e Punës Durrës, Profesorë nga Univeristeti "Aleksandër Moisiu" si dhe Drejtore Ekzekutive e Shoqatës "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare" znj. Miranda Mansaku dhe Drejtore Ekzekutive e KRK znj. Dafina Peci. Të rinjtë pjesëmarrës patën mundësinë të diskutonin dhe të adresonin nga afër problemet e tyre.

Shtator 2019

- Më **13 shtator** përfaqësues nga AIDA - Albanian Investment Development Agency zhvilluan **takimin informues** lidhur me fondet që do të jepeshin për bizneset në qytetin e Durrësit në Qendrën Rinore Multifunkionale "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare".

Tetor 2019

- Më **25 tetor** Stafi i Shoqatës "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare" zhvilloi **online meeting me Anëtarë të Bordit Drejtues të URI Europe** për të qënë zyrtarsihet anëtarë të këtij rrjeti. Online meeting erdhi si rezultat i takimit të zhvilluar në Asmablenë Rajonale të URI Europe Në këtë takim morën pjesë 6 përfaqësues të organizatës të cilët ishin besimtar të 3 besimeve të ndryshme fetare. Kjo tregoi frymën e tolerancës që mbizotëron në shoqatë, e cila çon përpara zhvillimin e iniciative të reja.

- **26 Tetor** Shoqata hapi **thirrjen për zhvillimin e intershipeve** në ambientet e Qendrës Rinore Multifunkionale "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare". Thirrja kishte si qëllim aftësimin e të rinjve në qytetin e Durrësit dhe paisjen me dije praktike për funksionimin e OSHC-ve.

Nëntor 2019

- Më **11 Nëntor** Kongresi Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Shoqatën "Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare" zhvilloi **takimin e dytë** "Manuali mbi qytetarinë Aktive - Forcimi i rolit të të rinjve në procesin e përafrimit të Shqipërisë në BE" dhe një **sesion informues** nga Regional Youth Cooperation Office WB, RYCOWB.

- Më **18 Nëntor** në ambientet e Qendrës Rinor Multifunkionale "Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare", Qendra ALTRI zhvilloi **takimin informues** me të rinjtë punëkerkues në kuadër të iniciativës "Zhvillojmë idetë e të rinjve në qytetin e Fierit, Durrësit dhe Kukësit" i cili mbeshtetet nga GIZ Albania/ProSEED.

- Më **21 Nëntor**, në kuadër të Ditës Kombëtare të Bullizmit në Ambientet e qendrës Rinor Multi-funkionale "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare" u zhvillua **takimi me psikologjen** me temë "Menaxhimi i ankthit dhe stresit". Pjesëmarrës në të ishin të rinjtë që e kërkuan këtë takim. Psikologjia A. Panteqi iu dha të rinjve këshilla të vlefshme e praktike lidhur me menaxhimin të stresit në situata të ndryshme që mund të gjendeshin.

- Pas tërmetit të datës **26 nëntor** stafi dhe vullnetarë të Shoqatës "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare" janë angazhuar në **ofrimin e ndihmave dhe shërbimit psiko-social** për familjet e prekura nga tërmeti. Ata i kanë qëndruar pranë fëmijëve dhe të rriturëve që nga akomodimi në çadra përpara stadiumit "Niko Dovana", më pas në kampin provizor në palestrën e shkollës "Benardina Qerraxhi" dhe tek hotel Bonita në Golem. Dhënia e këtij Shërbimi vazhdoi edhe në muajin **Dhjetor**. Gjatë kësaj kohe ata zhvilluan aktivitete të ndryshme argëtuese dhe kreative me fëmijët. Ndër to përmendim shpërndarjen e ndihmave së bashku me psrtnerët e tyre si : Arci Brindisi, UNDP, URI Europe, lojra kreative, fokus grupe, këshillime, festën e Krsihtlindjes si dhe ekspozita.

- Shoqata "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare" si koordinatore lokale e Kongresit Rinor Kombëtar mori pjesë në **Konferencën finale** ku u prezantuan Planet Lokale të Veprimit të 12 Bashkive me rastin e 8 Dhjetorit - Ditës Kombëtare të Rinisë, **8 Dhjetorit**.

2. Pjesëmarrje në aktivitete të tjera në kuadër të bashkëpunimeve me struktura dhe donatorë të ndryshëm

Janar 2019

Workshop në kuadër të thirrjes "JS Interreg IPA CBC Italy-Albania-Montenegro"

Më 23 janar përfaqësues nga Shoqata "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare" morën pjesë në workshopin e zhvilluar në kuadër të thirrjes "JS Interreg IPA CBC Italy-Albania-Montenegro". Qëllimi i këtij workshopi ishte të informonte pjesëmarrësit për mënyrën e aplikimit në këtë thirrje.

Takimi i hapur

Më 30-31 janar Drejtoresha Ekzekutive e shoqatës mori pjesënëtakimin e hapur të zhvilluar nga Konrad Adenauer Stiftung. Ky takim ishte i ndarë në katër panele që trajtonin temat: "Infrastructure Development in Albania/Balkan and financing in the EU", "The challenges of vocational education and training in Albania", etj. Nga panelet e diskutimit u mbajtën shënime temat dhe pikat kryesore që do të ndihmonin shoqatën në përmirësimin e punës së saj.

Takim

Përfaqësues të shoqatës morën pjesë në takimin e zhvilluar nga CODE Albania me temë “Të rinj të me aftësi të kufizuar – ndërtues të komuniteteve gjithëpërfshirëse”.

Shkurt 2019

Më 1 shkurt Drejtoresha Ekzekutive e shoqatës mori pjesë në **Konferencën Ndërkombëtare “Ndërmarrjet Sociale – Drejt Politikave dhe Praktikave Përfshirëse”**. Kjo konferencë zhvilloi në Tiranë nga “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” dhe “Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim”. Qëllimi i saj ishte informimi për ndërmarrjet sociale në Shqipëri dhe boshllëqet në kuadrin ligjor shqiptar për këtë fushë.

Më 4 shkurt përfaqësues të Shoqatës “Udhëtim i Lirë– Liberi di Viaggiare” morën pjesë në **takimin prezantues** të projektit “Monitorimi alternativ i cilësisë së ajrit, ndotjes nga zhurmat dhe gjelbërimit urban në Bashkinë e Durrësit” për të parë punën që po bëhet në qytetin e Durrësit në mënyrë që të mos ketë mbivendosje.

Takim konsultativ për përcaktimin e prioriteve për bashkinë Durrës në kuadër të #ReLOaD

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të shoqatës të cilët adresuan dhe dhanë mendimin e tyre lidhur me prioritetet që duhet të vendoseshin në kuadër të kësaj thirrje. Propozimet e tyre lidheshin me fushën e rinisë, punësimit dhe turizmit.

Ditë e hapur “Thirrja e dytë publike për projekt propozime programi #ReLOaD për Bashkinë Durrës”

Në të morën pjesë grupi i punës që do të merrej me aplikimin dhe shkrimin e projekt propozimit për vitin 2019 në kuadër të thirrjes. Ata mbajtën shënime pikat kryesore që do të vlerësoheshin në shkrimin e projekt propozimit.

Prill 2019

Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” mori pjesë në **lancimin e Qendrës Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri** dhe dha kontributin e saj në gjetjen e problemit dhe hasin OSHC në punën e tyre.

Përfaqësues të shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” morën pjesë në **tryezën e rumbullakët** të zhvilluar në Europe House. Në diskutimin e zhvilluar me Drejtoreshën për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian dhe Shefen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Genoveva Ruiz-Calavera për çështjet aktuale shqetësuese. Si të rinjtë mund të kontribuojnë në procesin e integritetit në BE të vendit dhe rajonit të rinjtë dhanë idetë dhe sugjerimet e tyre.

Nga data 04.04.-07.04 shoqata u përfaqësua në **International Network meeting** që u zhvillua në Korfuz nga Deutsche Schreberjugend Bundesverband e.V. Në këtë exchange kishte përfaqësues nga shtetet : Gjermania, Finlanda, Irlanda e Veriut, Greqia. Temat e trajtuara në të ishin zhvillimi i qëndrueshëm, mjedisi, barazia gjinore, angazhimi rinor, dhe vlerat kulturore të secilit shtet.

Nga data 30.04-05.05. Drejtoresha Ekzekutive e shoqatës mori pjesë në **“Civic Academy for young disseminators from France, Germany and the Western Balkans”**. Në këtë akademi kishte pjesëmarrës nga Gjermania, Franca dhe Vendet e Ballkanit Perëndimor të cilët shkëmbyen praktikat e mira në fushën e të rinjve dhe edukimit joformal.

Maj 2019

Në javën e Europës 6-11 maj përfaqësues të shoqatës morën pjesë në një sërë aktiviteteve si : shkëmbimi i ideve mes ambasadorëve të BE dhe të rinjve shqiptar lidhur me kontributin e të rinjve në integrimin evropian të Shqipërisë. Aktiviteti tjetër në të cilin të rinjtë morën pjesë ishte edhe të mësuarit sipërmarrës dhe mbështetja e BE-së për të rinjtë.

Shoqata "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare" mori pjesë në takim që u zhvillua në bibliotekën e universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës për **promovimin e bibliotekës digjitale EBSCO**, e cila i vjen në ndihmë studentëve. Promovimin e bibliotekës digjitale e bëri vetë Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, znj. Besa Shahini. Shoqata me të rinjtë e saj e sheh si një mundësi të mirë të cilën mund ta promovoj dhe implementoj.

Një grup pune nga shoqata morën pjesë në **sesionin informues** që u zhvillua nga Terre Des Hommes Albania në kuadër të thirrjes për projekt propozime **“Civil society in action to build restorative approaches and practices for children and youth in conflict or contact with the law”**.

Shoqata "Udhëtim i Lirë - Liberi di Viaggiare" mori pjesë në **konferencë "Zhvillimi i kuadrit ligjor në fushën e Rinisë"** të organizuar nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe UNFPA në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015-2020.

Qershor 2019

Me datë 2 dhe 3 qershor shoqata mori pjesë në **aktivitetin “Përfshirja e komunitetit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe në krijimin e komuniteteve të qëndrueshme”**. Ky aktivitet u zhvillua nga IDM dhe kishte si qëllim krijimin e strategjive për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në komunitetet vendore.

Më datë 12 qershor shoqata mori pjesë në prezantimin **“Performanca e Buxhetit 2018”**. Ky prezantim u zhvillua nga Bashkia e Durrësit me asistencë nga projekti “Bashki të forta”. Pjesëmarrës në të ishin përfaqësues nga drejtoritë e bashkisë Durrës, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues nga Qarku i Durrësit.

Në 25 qershor të rinjë vullnetar nga shoqat morën pjesë në **trajnimin** që Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim organizuan në Durrës për shkrimin e projekt propozimeve sipas standardeve evropiane.

Korrik 2019

Me datë 10 Drejtoresha Ekzekutive mori pjesë **trajnimin informues** me temë Application Procedures for “Europe for Citizens” Programme. Ky trajnim u zhvilluar nga Ministria e Kulturës dhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme. Informacionet e marra u përdorën më pas në shkrimin e projekt propozimit.

Më 15 korrik vullnetarë të Shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” morën pjesë në **Mbledhjen e Shtatë të Asamblesë së Përgjithshme** të Kongresit Rinor Kombëtar. Pjesëmarrësit dhanë sugjerimet e tyre në diskutimet që u zhvilluan në sesionet paralele.

Me datë 18 përfaqësues nga Shoqata “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” morën pjesë në **“Business Forum Albania – Croatia”**. Qëllimi i këtij takimi ishte krijimi i bashkëpunimeve mes bizneseve dhe organizatave nga Shqipëria e Kroacia.

Drejtoresha Ekzekutive znj. M.Mansaku mori pjesë në **takimin** që zhvilloi ambasadorja franceze SH. S. Znj. Christina Vasak, ambasadorj zëvendës sekretarin e përgjithshëm të RYCO-s z. Fatos Mustafa dhe sekretarin e parë të Ambasadës Gjermane z. Enrico Gënther mbi perspektivat e aktivizmit rinor dhe përafrimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian. Gjithashtu u diskutua mbi mësimet që mund të nxirren nga pajtimi gjermano-francez për paqen në Ballkanin Perëndimor. Projekti u zbatua nga Akademia Evropiane e Otzenhausen së bashku me Federalistët e Rinj Evropianë. Aktivitetet e rrjetit ndërkombëtar të të rinjve financohen që prej vitit 2017 nga Zyra e Jashtme Federale.

Gusht 2019

Më datë 05 gusht anëtarë të stafit të Shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” morën pjesë në **Online Mentoring** të zhvilluar nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, i cili kishte si qëllim rritjen e kapaciteteve të OSHC.

Më datë 08 gusht anëtarë të stafit të Shoqatës morën pjesë në **online mentoring me temë “Komunikimi Strategjik”** të zhvilluar nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile.

Shtator 2019

Stafi i Shoqatës UiL – LdV mori pjesë në trajnimin **Trajnimin “Përfitimi nga Fondet e Bashkimit Evropian, Programet Evropiane”**. Ky trajnim u zhvillua nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim si dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile.

Tetor 2019

Drejtoresha Ekzekutive mori pjesë në **Asmablenë Rajonale të URI Europe me temë “Twenty plus – the 20 year URI journey: Cultivating inter-religious and inter-cultural dialogue, action & harmony in Europe”**. Aktiviteti u zhvillua nga data 03-06 tetor 2019 në Ohër, Maqedoni.

Vullnetarë të Shoqatës morën pjesë në **tryezën e rrumbullakët** të zhvilluar nga Kongresi Rinor Kombëtar. Ky takim u zhvillua në kuadër të projektit “Të kuptojmë emigracionin e të rinjve – Koha për një narrativë të re” dhe kishte si qëllim prezantimin e studimit të kryer.

Në kuadër të Muajit të Librit përfaqësues të Shoqatës UiL – LdV morën pjesë në **takimin me shkrimtarin** durrsak Loer Kume, fitues i çmimit "Kadare" 2019 me vëllimin me tregime "Amygdala Mandala".

Më 30 tetor përfaqësues të Shoqatës morën pjesë në **trajnimin** me zyrtarë vendor për trajtimin e shkaqeve të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Qëllimi i këtij trajnimi ishte informimin dhe ndërgjegjësimi për parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ky trajnim u zhvillua nga Qendra e Koordinimit kundër EDH.

Nëntor 2019

Përfaqësues të Shoqatës morën pjesë në 4th annual Regional Youth Leadership Forum nga data 22-24 Nëntor 2019 që u zhvillua në Novi Sad. Qëllimi i këtij forumi ishte bërja bashkë e të rinjve nga gjithë rajoni për diskutimin e problematikave që të rinjtë kishin dhe adresimin dhe përmirësimin e tyre. Forumi u zhvillua nga Belgrade Fund for Political Excellence dhe European Movement in Serbia - local council Novi Sad.

Dhjetor 2019

Drejtoresha Ekzekutive e Shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare” mori pjesë në takim për Koordinimin e punës pas tërmetit që preku qytetin e Durrësit.

Drejtoresha Ekzekutive e Shoqatës UiL – LdV mori pjesë në takim që zhvilloi UNDP me OSHC partnere që punojnë në bashkitë e Durrësit dhe Tiranës për të diskutuar nevojat e emergjencave që duheshin adresuar pas tërmeteve. Si një nga organizatat lokale që iu gjend pranë familjeve të prekura nga tërmeti në qytetin e Durrësit, znj. Mansaku adresoi vevojat emergjente që këto familje kishin.

3. Anëtaresime në rrjete

Shoqata “Udhëtimi i lirë” është pjesë e disa rrjeteve si më poshtë:

- ✓ Anëtare e rrjetit ndërkombëtar Anna Lindh Foundation.
- ✓ Anëtare e Kongresit Rinor Kombëtar.
- ✓ Anëtare e rrjetit ndërkombëtar Earth Day Network.

- ✓ Anëtare e GKP (Grupit Kombëtar të Punës) për RAP (Reformën në Administratën Publike).
- ✓ Anëtare e Platformës së Bashkëpunimit Rinor të Ballkanit Perëndimor.
- ✓ Anëtare e rrjetit Skillman
- ✓ Anëtare e rrjetit Green Growth Community
- ✓ Anëtar të URI Europe (United Religions Initiative)

4. Partnerë të organizatës

Shoqata “Udhëtimi i lirë” ka ndërtuar një bashkëpunim dhe mbështetje nga struktura të ndryshme, të cilat janë pjesë e nismave dhe projekteve që janë implementuar dhe po implementohen kjo e fundit:

- ✓ Bashkia Durrës (Marrëveshje bashkëpunimi datë 27.04.2017 Nr. 9591 Prot)
- ✓ Këshilli i Qarkut Durrës (Marrëveshje bashkëpunimi datë 22.08.2017 Nr. 975 Prot)
- ✓ Bashkia Shijak (Marrëveshje bashkëpunimi datë 21.08.2017 Nr. 2992 Prot)
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (Marrëveshje bashkëpunimi datë 08.11.2019 Nr. 1574 Prot)
- ✓ Kongresi Rinor Kombëtar
- ✓ Shkollat 9 dhe 12 vjeçare jopublike: “Ibrahim Kodra”, “Eneida”, “Migjeni”, “Mihal Ekonomi”
- ✓ Shkollat e mesme të përgjithshme “Naim Frashëri”, “Gjergj Kastioti”, “Leonik Tomeo”, “Olsi Lasko”, “Dom Nikoll Kaçorri” Durrës.
- ✓ Shkolla e mesme sportive “Benardina Qerraxhi”
- ✓ Shkolla e mesme e profesionale “Beqir Çela”, “Hysen Çela”.
- ✓ Shkolla e mesme artistike “Jan Kukuzeli”

5. Donatorë

Shoqata “Udhëtimi i lirë” është mbështetur financiarisht në iniciativat e saj, nga:

- ✓ IDM (Institute for Democracy and Mediation) përmes fondeve EU,
- ✓ REC përmes programit Senior,
- ✓ Bashkia Durrës
- ✓ Raiffeisen INVEST
- ✓ Këshilli i Qarkut Durrës
- ✓ UNDP përmes programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor
- ✓ Ambasada Bullgare në kuadër të programit "Ndihma zyrtare për zhvillim".
- ✓ EU përmes programit Erasmus +

6. Projekte të përfunduara

➤ Projekti “*Qytetarë aktiv në monitorimin dhe përmirësimin e qeverisjes vendore në Bashkinë e Shijakut*”, i cili u zbatua gjatë harkut kohor 01.05.2017 – 31.10.2017 dhe mbështetur nga fondi i nëngrantimit "Lot 1- Anti-korrupsioni dhe zhvillimi i kapaciteteve" në kuadër të projektit CIVILISC, zbatuar nga IDM, financuar nga BE.

Në kuadër të këtij projekti u ndërmorën këto aktivitete:

1. *takime me bazë komunitare me target grupe të ndryshëm të zonës së Shijakut*
2. *fokus grupe dhe intervista me antarë të ndryshëm të komunitetit (biznese, ndërlidhësa komunitarë, ëprfaqësues të strukturave shtetërore lokale etj) me qëllim evidentimin e nivelit të kënaqësisë së shërbimeve të ofruara nga pushteti lokal ndaj qytetarëve.*
3. *hartimi i një raport vlerësimi mbi shërbimet publike në Bashkinë Shijak*
4. *takime ndërgjegjësuese mbi rëndësinë e pjesëmarrjes qytetare në qeverisjen publike dhe nxitjen e llogaridhënies nga ana e struktrave të pushtetit lokal ndaj qytetarëve.*

➤ Projekti “*Youth Eco Act*” i cili përfundoi më 30.09.2018. Ky projekt është i mbështetur nga Grantet Opceracionale të programit "Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile në fushën e Mjedisit në Shqipëri (SENiOR-II) që zbatohet nga REC - Qendra Rajonale e Mjedisit në Shqipëri, mbështetur dhe financuar nga Ambasada Suedeze në Tiranë.

Në kuadër të këtij projekti janë realizuar:

- *Vendosja e koshave të diferencuar në shtet arkeologjike të qytetit dhe në disa shkolla target të projektit ;*
- *Trajnime me grupin e vullnetarëve mbi rëndësinë e edukimit mjedisor dhe riciklimit ;*
- *Takime ndërgjegjësuese me nxënës të shkollave të mesme, target të projektit ;*
- *Hartimi dhe publikimi i planit strategjik të shoqatës;*
- *Ekspozita “Turizmi & Riciklimi” u zhvillua nga data 18.04.2018 – 22.04.2018 e cila përkon me ditën e Monumenteve kulturore dhe ditës së Tokës. Në të cilën morën pjesë nxënës nga pesë shkolla të mesme të qytetit të Durrësit. Secila nga shkollat dhe secili nga nxënësit morën çertifikatë pjesëmarrje. Tre nxënësit me punimet më të mira morën çertifikatë vlerësuese.*
- *“Dita pa qese plastike” në të cilën vullnetarët e shoqatës shpërndan çanta për të ndërgjegjsuar blerësit për mospërdorimin e qeseve plastike.*

➤ Projekti "Clean today -Healthy Tomorrow" me mbështetjen e Raiffeisen Invest dhe në bashkëpunim me pesë shkollat e mesme të qytetit të Durrësit si: Benardina Qerraxhi, Olsi Lasko, Beqir Çela dhe Dom Nikoll Kaçorri.

Në kuadër të këtij projekti janë realizuar:

- *Vendosja e koshave të diferencuar në shkolla e targetuara për këtë projekt;*
- *Trajnime me grupin e vullnetarëve mbi rëndësinë e edukimit mjedisor dhe riciklimit;*
- *Takime ndërgjegjësuese me nxënës të shkollave të mesme, target të projektit;*

▪ *Ekspozita përmyllëse në datë 05.06.2018 në kuadër të ditës së Mjedisit, me tematikë “Monumente arkeologjike me materiale të ricikl-ueshme”.* Të gjithë nxënësit që morën pjesë me punime u paisën me çertifikatë pjesëmarrje ndërsa nxënësit Ervis Dautaj, Belkiza Gjipali dhe Afrim Lleshi morën përkatësisht vendin e parë, të dytë dhe të tretë. Shkolla “Beqir Çela” fitoi edhe pemën e ullirit për shkak të numrit të lartë të punimeve që paraqit në ekspozitë. Përmes krijimeve të nxënësve u përcoll edhe njëherë mesazhi se sa të rëndësishëm janë mjedisi dhe monumentet kulturore në qytetin e Durrësit. Ekspozita u publikua në rrjetet sociale dhe median lokale duke e rritur ndjeshëm ndërgjegjësimin e publikut.

➤ Nga **01.04.2018 – 31.03.2019**, shoqata në bashkëpunim me Fondacionin “Së Bashku” ka zhvilluar një cikël trajnimesh në kuadër të projektit *“Forcimi i kapaciteteve të organizatave të aftësisë së kufizuar në Durrës dhe ngritja e çështjes së aksesueshmërisë me të gjithë aktorët lokalë”.* Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Trajnimet kishin temat si më poshtë:

▪ “Lidershipi dhe Advokacia” në të cilin morën pjesë aktivist dhe përfaqësues të organizatave të aftësisë së kufizuar në Durrës si dhe vullnetar të shoqatës “Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare”.

▪ “Modelet e aftësisë së kufizuar dhe statistikat, Konventa e OKB-së dhe legjislacioni shqiptar” dhe këtu pjesëmarrja ishte e lartë si nga ana e përfaqësuesve të organizatave të aftësisë së kufizuar në Durrës dhe nga vullnetarët tanë.

▪ “Menaxhimi i organizatave dhe çështjet financiare”, në këtë trajnim morën pjesë individë nga organizatat e aftësisë së kufizuar në Durrës të cilët dëshironin të zgjeronin njohuritë e tyre për çështjet financiare.

▪ Një sesion i veçantë dedikuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për eliminimin e barrierave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuar”.

▪ “Soft skills”